


TI JE

DEMOKRACIJA
REMARKIBREKIDR
EARJESTVES
JNIEAPINIY
TC TKTEVLTE
ÈI O T I K I I I
S P K I V T Z Z T
I I R V I I I E
M A I T M M T
C I T E
I ET T

DEMOKRACIA NA JEP FUQI PËR VENDIMARRJE

ALDINI (12), ARGJEND (12), ALMIR (12), MEDINA (12)



Shteti ynë ka demokraci përfaqësuese. Si rezultat i kësaj, ne i zgjedhim përfaqësuesit tanë me anë të votave

Demokracia për herë të parë është paraqitur në Greqi në vitin 507 para erës sonë. Domethënia e fjalës demokraci është udhëheqje e popullit. Kjo udhëheqje ka disa elemente, mbi të cilat ajo qëndron. Këto elemente janë: respekti, toleranca, solidariteti, liria, etj. Njërën prej këtyre elementeve dhe jo të vetmin, ne e përdorim herë pas here në klasën tonë. Kujdestarja e klasës shpeshherë na jep detyra javore, të cilat janë projekte të ndryshme. Më pas ndahemi në grupe, ku secili prej nesh jep kontribut në realizimin e atyre projekteve. Në këtë mënyrë ne zbatojmë të gjitha elementet e përmendura më lart. Kjo e dëshmon atë që thotë populli: „një mendje si asnjë mendje, dy mendje si një mendje“. E kur jemi më shumë, pa dyshim se do të jemi më të suksesshëm. Pra, me këtë dëshirojmë të themi se bashkimi i disa ideve sjell finalizim më të mirë të punës.

Në Kosovë kemi demokraci përfaqësuese, ku ne qytetarët votojmë dhe zgjedhim përfaqësuesit tanë të cilët janë deputetët. Deputetët tanë kanë përgjegjësi ndaj popullit, sepse ata e kanë fituar këtë pozitë me qëllim që t'i mbrojnë interesat dhe kërkesat e qytetarëve. Demokracinë mund ta përkufizojmë si pranim i të tjerëve për atë që ata janë, sepse që të gjithë jemi të barabartë pa dallim feje, race, gjinie, moshe, apo diçkaje tjetër.



Bashkëpunimi në grup



Gazetarët e artikullit të demokracisë

TË BËHEMI AKTIV PËR TË MIRËN E KOSOVËS


REDON (12), ERLIND (12), ELIONA (12), ANISA (12)

Një qytetar aktiv sigurohet që të gjithë të kenë një jetë aktuale të mirë dhe një të ardhme të ndritur


Të qenurit qytetarë në një shtet demokratik, siç është Kosova është një bekim i madh. A e dini pse? Sepse ne kemi mundësi dhe të drejta të shumta për një jetë të mirë. Por, cilat janë ato të drejta, të cilat na e lehtësojnë jetën tonë? Të drejtat tona si qytetarë janë: e drejta e shprehjes së lirë së mendimit, e drejta e shkollimit, e drejta e emrit, e drejta e votës, e drejta e lëvizjes, e drejta e punësimit, etj. Ne si nxënës, gjithashtu kemi përgjegjësi të shumta. Ato na bëjnë neve më të përgjegjshëm dhe më të përgatitur për jetë. Disa prej tyre janë: vijimi i rregullt i mësimëve, përfundimi i detyrave me kohë, respektimi i rregullave të shkollës, respektimi dhe zbatimi i rregullave të komunikacionit, etj.

Çka na bënë neve të jemi qytetarë aktiv? Të jemi qytetarë aktiv do të thotë të bëjmë punë të ndryshme, të cilat do të mund t'i ndihmonin komunitetit tonë, të bëjmë punë vullnetare, të marrim pjesë në procesin zgjedhor, etj. Çka ne planifikojmë të bëjmë më shumë për Prishtinën tonë është të krijojmë më shumë hapësira me gjelbërim, më shumë vende për rekreacion të rinjëve, etj. Duke qenë pjesë e këtyre punëve vullnetare, ne përveç se përfitojmë njohuri dhe shkathtësi të reja të punës, ne gjithashtu u ndihmojmë të rinjëve dhe të gjithë qytetarëve të tjerë që të jetojnë në një ambient të shëndoshë demokratik.

Shpresojmë që artikulli ynë do të ndikojë në aktivizimin tuaj, të dashur lexues.



Paqja mbi të gjitha



Populli është ai i cili merr vendime për shtetin



Një mënyrë tjetër e të qenurit qytetarë aktiv





Gazetarët e artikullit të Qytetarisë Aktive

RËNDËSIA E QEVERISË NË JETËN TONË

ALTIN (12), ENDRITA (11), SUELA (12), BLERONA (12), BLEON (12), ALBION (12), VANESA (12),

ERION (12)



Grupi ynë në këtë artikull flet në emër të Kryeministres së Kosovës

Shumë të dashur lexues. Përmes këtij artikulli, po iu flet Kryeministria e vendit tuaj, Kosovës.

Unë si Kryeministre kam shumë përgjegjësi që i kryej me shumë përkushtim. Ju e dini se unë jam në krye të Qeverisë. Institucion ky që ushtron Pushtetin Ekzekutiv dhe që zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës. Kuvendi përpos që zgjedh Qeverinë, gjithashtu kontrollon punën që bëjmë ne. Kjo sepse ne kemi për detyrë të propozojmë projektligje dhe ato projektligje i dërgojmë në Kuvend. Nëse më shumë se gjysma e deputetëve votojnë pro projektligjit, atëherë projektligji miratohet. Pasi të miratohet, ai hyn në fuqi dhe bëhet ligj.

Kurse, ne si Qeveri, kemi për detyrë që ta vëmë në funksion dhe ta zbatojmë atë. Prandaj, për këtë arsye Kuvendi na kontrollon nëse ne po i zbatojmë ligjet siç duhet apo jo. Mirëpo, bashkë me neve, ligjet i zbatojnë edhe qytetarët tanë. Në këtë mënyrë, jeta e të gjithë neve është e strukturuar dhe e sigurt.

Si Kryeministre, unë kam nevojë që të kem rreth vetes persona të tjerë që më ndihmojnë në punën time. Këta persona që punojnë bashkë me mua janë: zëvendëskryeministrit, ministrit dhe zëvendëskryeministrit. Puna që ne bëjmë është e ndarë. Për shembull, secili ministër është në krye të një ministrie që merret me një fushë të caktuar. Marrim shembull, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Shën-

detësisë, Ministrinë e Infrastrukturrës, etj. E gjithë kjo bëhet që të gjithë qytetarët e shtetit tonë të kenë një jetë sa më të organizuar.

Njëra prej tyre është Ministria e Infrastrukturrës. Kjo ministri kujdeset që të gjitha rrugët e Kosovës të jenë në gjendje të rregullt. Në këtë mënyrë qytetarët do të jenë të siguarur në rrugë dhe jetërat e tyre nuk do të rrezikohen. Kështu bëjnë edhe ministritë e fushave të tjera. Secila ministri kujdeset që të punoj për interesat dhe nevojat e qytetarëve në fushat e caktuara. Kështu, ne iu tregojmë qytetarëve se çfarë ka punuar secila ministri, përmes deputetëve të cilët na bëjnë pyetje gjatë mbledhjeve tona me ta, që njihen si seanca plenare.

Unë ju përshtes dhe uroj që ju lexues të dashur të punoni sa më shumë për demokracinë, sepse ju jeni demokracia.



Gazetarët që shkruan këtë artikull duke luajtur rolin e Kryeministres

ROLI I MEDIAS NË DEMOKRACI

BETIM (12), LORESA (11), GRESA (13), DIANA (12), RIDVAN (12), SARA (12), ERMAL (12),

ALTINA (12)



Kur mami dhe babi im dëshirojnë të dalin të votojnë, ata informohen nga lajmet dhe nga medime të ndryshme se cili nga kandidatët është më i miri...

Unë e di se mediat kanë rol shumë të rëndësishëm në jetën tonë. Ato na japin informacione të ndryshme, të cilat na nevojiten shumë. Pa media nuk do të kishte as gazetarë. Kurse pa gazetarë, jeta jonë do të ishte e errët. Kur unë dua të mësoj diçka të re në botë drejtohem gjithmonë tek mediat. Ndez TV, shpalos gazetat ditore, ndezi kompjuterin dhe kyçem në rrjete sociale si dhe lexoj libra. Kjo na tregon se sa e rëndësishme është media në jetën time.

Por, jo vetëm këto media na sjellin informacione. Edhe ne mund të jemi ata që japim informacione tek të tjerët. Një ditë, shoqja e klasës sime mungoi gjatë tërë ditës. Në orët mësimore ne mësuam gjëra të reja dhe unë me

anë të mediave e informova atë pasi arrita në shtëpi. Ajo më falenderoi dhe tha se i ndihmova shumë që të mos ngec prapa në mësimet. Atëherë mendova, çfarë do të bënim ne sikur të mos ishin mediat...?

Mediat ndahen në të shkruara dhe elektronike. Ato duhet të jenë të drejta, të sakta, të pavarura dhe të paanshme. Mirëpo, ne qytetarët duhet të kemi edukim medial. E çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm në informacionet që marrim, duhet të kontrollojmë burimet tona dhe të kërkojmë burime shtesë mbi informatat që i kemi marrë.

Duke e ditur që mediat bëjnë pjesë në demokraci, për to themi se janë pushteti i katërt. Pa to nuk do të kishte demokraci, pa to nuk do të kishte respektim të të drejtave tona dhe pa to nuk do të ishim as ne. Faleminderit mediave për punën që e bëjnë!



Unë gjithashtu mund të informoj të tjerët



Yjet e Medias

VOTO EDHE TI

TEJMIR (12), SAMELA (12), AGNESA (12), ERONA (11), MALSOR (12), SAMIR (12), OLTA (12), ELVIRA (12),

ARNIS (13)

Vota juaj
është zëri
juaj!



Rëndësia e zgjedhjeve në demokraci...

Kohëve të fundit, disa nga gjërat që më së shumti i kemi dëgjuar janë zgjedhjet, të cilat do të mbahen në tetor të këtij viti. Janë zgjedhjet lokale, aty ku qytetarët mbi moshën 18 vjeçare do të marrin pjesë duke votuar. Disa nga ta, do të kenë rastin që për herë të parë të votojnë, e për disa të tjerë ky veçse është një veprim shumë i pritur dhe i dashur. Kjo sepse përmes zgjedhjeve, populli i voton përfaqësuesit e vet.

Zgjedhjet lokale mbahen çdo 4 vjet. Në këtë lloj të zgjedhjeve, qytetarët votojnë për kryetarin e komunës si dhe për asamblenë komunale. Çka ne si nxënës kemi mësuar për këto lloje të zgjedhjeve është se kandidatët për asamblenë komunale duhet të jenë qytetarë të komunës përkatëse. Për shembull, prindërit tanë do të votojnë për Asamblenë Komunale të Prishtinës, pasi që ne jemi nga kjo komunë. Pra, hapi i parë që duhet plotësuar është të jenë qytetarë të asaj komune. Pastaj, ne kërkojmë nga kandidatët për asamble t'i plotësojnë disa kriteret, si: të jenë të afërt me qytetarët, t'i dëgjojnë brengat dhe hallet që ata kanë, sepse zëri i qytetarëve do të jenë vetë assembleistët dhe kryetari i komunës. Kjo është për zgjedhjet lokale, por në vendin tonë kemi edhe zgjedhje qendrore. Në zgjedhjet qendrore, qytetarët përmes votës zgjedhin deputetët të cilët marrin vendime për të mirën e popullit. Deputetët punojnë në Kuvend, e për më shumë fakte rreth

Kuvendit do të informoheni në artikullin tjetër.

Me këtë artikull ne kemi dashur t'iu informojmë më shumë për zgjedhjet dhe rëndësinë e tyre, sepse me ditë të tëra jemi duke i dëgjuar dhe shikuar në televizion. Përkundër asaj që ne ende nuk e kemi fituar të drejtën e votës, ne e kemi kuptuar rëndësinë e saj dhe peshën e madhe që ajo ka. Sepse, vetëm një votë mund të sjellë ndryshim.

Në familjen e njëres prej shoqeve tona, kanë pasur një rast të ngjashëm, kur nëna e saj para 4 vjetëve ka qenë candidate për Asamblenë Komunale. Ajo vetëm për një votë më shumë e ka kaluar pragun dhe ka fituar. Pra, secila votë mund të sjellë ndryshim.

Raste të tilla kemi edhe në zgjedhjet e përditshmërisë. Kur dëshirojmë të luajmë ndonjë aktivitet, zakonisht vetëm një votë më shumë vendos për aktivitetin që do të zhvillohet. Vota e secilit është zëri i secilit, andaj shfrytëzojeni atë.



Puna në grup është puna më e mirë e realizuar


INSTITUCIONI MË DEMOKRATIK

Kuvendi është institucion, rëndësia e të cilit është shumë e madhe në jetën tonë. Kjo sepse falë tij, ne të gjithë qytetarët e kemi një jetë më të mirë dhe më të lehtë. Janë deputetët, ata të cilët marrin vendime për neve, qytetarët. Ashtu siç e cekëm më lart, deputetët janë përfaqësues të popullit, spese është populli ai i cili i zgjedhë dhe iu jep mandat për të udhëhequr për katër vjet me radhë. Pa dyshim, kur themi se puna e Kuvendit ka shumë rëndësi për qytetarët, nënkuptojmë se ligjet që miratohen në Kuvend janë në të mirën e të gjithë vendit. Ligji për shenja të komunikacionit, marrim shembull, jo vetëm që na lehtëson jetën, por po ashtu na ruan jetën tonë duke parandaluar rreziqet e mundshme të komunikacionit. Ose, semaforët, vetëm imagjinojeni ju, të dashur lexues një qytet pa semaforë! E dijmë mirë se çfarë pamjesh ju kanë ardhur në mendje; gjasat për lëndime të ndryshme të pjesëmarrësve në trafik do të rriteshin, ajri do të is-


hte shumë i ndotur e shumë të tjera. E dijmë, sepse kështu do të ishte po të mos ekzistonin semaforët dhe shenjat e tjera të domosdoshme të komunikacionit. Si ky ligj, kemi edhe shumë të tjerë, roli i të cilëve është shumë i madh. Për ne si fëmijë, ligji për familje dhe për arsim janë ligjet më të rëndësishme. Kur jemi te familja, kjo është gjëja më me rëndësi në jetë, sepse një familje e mirë është baza e një brezi të arsimuar. Ndërsa, ligji për arsim, u mundëson të gjithë qytetarëve që të kenë edukim bazik, që nënkupton se çdo qytetar i vendit tonë duhet të dijë shkrim dhe lexim. Të gjitha këto ligje dhe ato që nuk i kemi cekur, miratohen për të mirën tonë si qytetarë dhe për të ardhmen e vendit tonë. Nuk dëshirojmë ta përfundojmë artikullin, pa treguar pak edhe fakte rreth këtij institucioni shumë të rëndësishëm për ne. Këto fakte do t'i gjeni në vizatimet më poshtë.



Në Kuvendin e Kosovës punojnë 120 deputetë, të cilët janë përfaqësues të popullit. 100 prej tyre janë të kombësisë shqiptare, ndërsa 20 të tjerë iu përkasin komuniteteve jo shumicë



Kuvendi ka tri funksione kryesore: funksionin përfaqësues, sepse përfaqëson popullin; funksionin legjislativ, sepse miraton ligje si dhe funksionin kontrollues, sepse kontrollojnë punën që Qeveria e bën



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Hilmi Rakovica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë

Kjo kopje nuk është e redaktuar nga Kuvendi i Kosovës